

Niveli i II

B1 / B2

B1 – Mesatar: Studenti arrin të kuptojë pikat kryesore të mesazheve të qarta në gjuhën standarte, mbi argumenta të zakonshme që hasen në ambiente pune, në shkollë, në kohën e lirë, etj. Përballon situata të ndryshme që paraqiten gjatë një udhëtimi në vendin ku flitet kjo gjuhë. Di të hartojë tekste të thjeshta e koherente mbi argumenta për të familjare, ose që i interesojnë. Është në gjendje të përshkruajë eksperiencë, ngjarje, ëndrra, shpresa, dëshira dhe të paraqesë shkurtimisht arsyet e tij si edhe të japë shpjegime mbi opinione e projekte.

B2 – Mesatar i avancuar: Studenti arrin të kuptojë konceptet bazë në tekste të ndërlikuara si për argumenta abstrakte, ashtu edhe konkrete, përfshirë këtu edhe diskutime teknike të fushës së specializimit personal. Është në gjendje të komunikojë lehtësisht e natyrshëm dhe komunikimi me persona të gjuhës nënë zhvillohet pa shumë vështirësi dhe tension. Di të hartojë tekste të qarta dhe të detajuara mbi një gamë të gjerë tematikash e të shprehë opinionin personal mbi tema aktualiteti, duke paraqitur pro dhe kundra mbi opsionet e ndryshme.